

## **Të nderuar pjesëmarrës,**

Ju uroj mirëseardhjen në Samitin “Inovacioni në Zhvillim” i cili vjen në kuadër të projektit “ Rritja e Kapaciteteve Ndërkombëtare të Inovacionit për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme” financuar nga BE në kuadër të Programit të Bashkëpunimit Ndërkombëtar Interreg Balkan Med 2014-2020, që sjell së bashku 5 vende, 3 vende anëtare të BE-së dhe 2 vende candidate, ku një ndër to është dhe INSTAT.

Qëllimi i këtij projekti është të rrisë kapacitetet e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (NVM) dhe ti mbështesë ato në krijimin e një rrjeti të qëndrueshëm, duke përfshirë grupe inovative me NVM të tjera nga rajoni për të ndarë njohuritë dhe zhvillimin e inovacioneve, me qëllim reduktimin e hendekut në rajon mbi inovacionin e NVM-ve (SME), forcimi i konkurrueshmërisë së NVM-ve dhe përmirësimi i kapaciteteve ndërkombëtare të inovacionit.

Aktivitetet më kryesore të projektit janë, kryerja e anketës nga tri Institutet e statistikave ai i Shqipërisë, Bullgarisë dhe Maqedonisë së Veriut, zhvillimi i aplikacionit i vetëvlerësimit (SAT) dhe dhe përgatitja e raporteve të benchmarkut.

Në këtë projekt, INSTAT në rolin e partnerit të projektit ka kryer anketën mbi inovacionin e NVM-ve, si një nga aktivitetet kryesore të këtij projekti i cili është kryer edhe nga dy partnerë të tjerë në projekt, gjetjet paraprake të së cilës do të prezantohen me ju në këtë event, ndërsa rezultatet finale do të publikohen në Tetor.

Partneri Lider, “Shoqata Kombëtare e Bizneseve të Vogla dhe të Mesme, Bullgari” ka zhvilluar aplikacionin e vetëvlerësimit (SAT), e cila është një platformë treguesish për aspektet cilësore dhe sasiore që lidhen me anët ekonomike dhe financiare si dhe me projektet mbi inovacionin. Ky aplikacion, i lejon ndërmarrjet që përmes pyetësorëve që përmban të vetëvlerësojnë kapacitetet e tyre inovative, duke gjeneruar gjithashtu një raport me rekomandime për rritjen e kapaciteteve inovative. Gjatë eventit, bizneset do të keni mundësinë të testojnë aftësitë e tyre inovative nëpërmjet SAT të cilin mund ta aksesojnë në linkun e faqes së INSTAT të cilët do ta qarkullojmë me email tek të gjithë pjesëmarrësit dhe të interesuarit. Aktualisht, pyetësorët janë në gjuhën angleze dhe bullgare dhe së shpejti do të jenë të aksesueshme edhe në gjuhën shqipe.

Gjatë Samitit do të prezantohen me ju prioritetet kombëtare për Kërkim & Zhvillim dhe Inovacion, mekanizmat financiarë dhe mundësitë e financimit për NVM-të, projekte të financuara nga BE në fushën e Inovacionit, prezantimin e produkteve apo proceseve inovative të zhvilluara nga NVM-të si dhe praktikat më të mira në zhvillimin e ideve dhe inovacioneve në fushën e TIK.

Duke ju falenderuar për pjesëmarrjen, ju ftoj të ndiqni prezantimin mbi gjetjet paraprake të anketës mbi inovacionin e NVM-ve.

INSTAT, biznesin e konsideron një nga partnerët më të rëndësishëm për prodhimin e statistikave zyrtare në vend dhe do ta ketë gjithnjë e më shumë në konsideratë bashkëpunimin me të në vijim në fushat me interes të përbashkët.

Gjej rastin në këtë aktivitet për të shprehur mirënjohjen dhe konsideratën maksimale për ndërmarrjet të cilat kanë vënë në dispozicion informacionin dhe stafin e tyre për t'iu përgjigjur në kohë dhe me cilësi pyetësorëve të INSTAT-it, duke na mundësuar këto rezultate.

**Faleminderit!**